L I G J
Nr.8190, datë 30.1.1997

PËR SHPËRNDARJEN E PASURISË SË FONDACIONEVE QË KANË USHTRUAR VEPRIMTARINË E TYRE TË HUAMARRJES MBI BAZËN E SKEMAVE PIRAMIDALE MASHTRUESE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të vendosë rregulla për mënyrën dhe kriteret e shpërndarjes së pasurisë të fondacioneve, të cilat e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese, që më poshtë do të quhen "fondacione".

Për shpërndarjen e pasurisë së këtyre fondacioneve ndaj huadhënësve nuk zbatohen dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Neni 2

Në masën e detyrimit të fondacioneve kundrejt huadhënësve të tyre do të përfshihen shumat e llogarive të tyre të bllokuara në banka, të gjitha llojet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të themeluesve të fondacioneve, të drejtuesve në qendër e në rrethe, si dhe të gjithë personave të tjerë të cilët deklarohen fajtorë për bashkëpunim me themeluesit e fondacioneve për realizimin e skemave piramidale.

Neni 3

Të gjitha veprimet juridike që kanë kryer personat e parashikuar në nenin 2 të këtij ligji në lidhje me tjetërsimin e pasurisë së tyre tek personat e tretë, respektivisht nga data e themelimit ose e fillimit të marrëdhënieve të tyre me këto fondacione, janë të pavlefshme.

Neni 4

Të gjitha proceset civile në gjykatë ose në arbitrazh për përmbushje të detyrimit kundër fondacioneve dhe për personat e parashikuar në nenin 2 të këtij ligji ndërpriten dhe zgjidhen me procedurat e këtij ligji.

Neni 5

Çdo huadhënësi i njihet vlera e depozitës që rezulton mbi bazën e ekspertimit kontabël financiar të dokumentacionit të fondacioneve.

Neni 6

Shuma e fondeve të ngurtësuara për secilin fondacion pjesëtohet me shumën e detyrimeve ndaj depozituesve sipas nenit 5 të këtij ligji, për të nxjerrë koeficientin e shpërndarjes, i cili duhet të publikohet përpara fillimit të shpërndarjes.

Neni 7

Për zbatimin e nenit 6 dhe për problemet e tjera që lidhen me zbatimin e këtij ligji krijohet një komision i posaçëm me këtë përbërje:

1. Kryetari i Këshillit të Ministrave
2. Ministri i Financave
3. Ministri i Drejtësisë
4. Ministri i Brendshëm
5. Prokurori i Përgjithshëm
6. Guvernatori i Bankës
7. Drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, pranë të cilave janë depozituar paratë e këtyre fondacioneve.

Neni 8

Shpërndarja e shumave huadhënësve do të bëhet me para në dorë ose me libreza kursimi me afat sipas kritereve bankare, duke aplikuar edhe interesat për periudhën që ato do të qëndrojnë në bankë. Llogaritja e këtyre interesave bëhet duke filluar nga data e ngurtësimit të llogarive të fondacioneve. Zotëruesi i këtyre librezave ka të drejtë të tërheqë shumat nga librezat e kursimit dhe të prishë kushtet e saj sipas procedurave bankare për këtë qëllim.

Neni 9

Listat e depozituesve shpallen. Personat të cilët nuk do të gjejnë veten në lista dhe disponojnë dokumente autentike që vërtetojnë se janë huadhënës, u lind e drejta të ankohen pranë komisionit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji ose te një autoritet tjetër i përcaktuar prej tij.

Neni 10

Ministria e Privatizimeve organizon punën për vlerësimin me ekspertë të pasurive të paluajtshme të fondacioneve, si dhe të pasurive që rezultojnë nga transaksionet në emër të fondacioneve nga themeluesit dhe personat e tjerë të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji. Shitja e këtyre objekteve do të bëhet me ankand me lekë nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit.

Shumat e përgjithshme që do të rezultojnë nga shitja sipas paragrafit të parë të këtij neni do t'u shpërndahen depozituesve respektivë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 11

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë rregulla për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi më datën 30.1.1997

Shpallur me dekretin nr.1717, datë 31.1.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha